



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 6434 / prot.

Tiranë, më 08.11.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.740/1, datë 04.08.2014.

**SHOQËRISË “VËLLEZËRIT KACANI” SH.P.K
Rruga e Durrësit, Pallati Bimbashi, nr.14, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Vëllezërit Kacani” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.740/1, datë 04.08.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Fliballija”, Kavajë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresat nr.4155 prot., datë 18.04.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr. 6434 datë 18.04.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.740/1, datë 04.08.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Fliballija”, Kavajë, për arsye se nuk është miratuar programi vjetor i vitit 2017 – 2018, siç përcaktohet në gerrat “c” dhe “ç”, të nenit 25, Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Gjithashtu ka ndërprerë punën për më shumë se 180 ditë kalendarike, pa njoftuar më parë strukturat përgjegjëse për këtë ndërprerje, siç përcaktohet në ligjin që cituam më sipër.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në gerrat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.740/1, datë 04.08.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Fliballija”, Kavajë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.740/1, datë 04.08.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Fliballija”, Kavajë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ENIS ALIKO

